



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02Nr 516/2011
01.12.2011

Komuna Hani i Elezit në kuadër të projektit për bashkëpunim ndërkomunal me komunën e Kaçanikut realizon projektin “Shënimi i kufirit kadastral dhe mbrojtja e pyjeve”, në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare të UNDP-së dhe shpall këtë:

KONKURS PËR VENDE TË PUNËS PËR KOHË TË CAKTUAR PËR KËTO POZITA

- **2 Roje pylli (1 nga Komuna e Kaçanikut për teritorin e Kaçanikut dhe 1 nga Hani i Elezit për teritorin e Hanit të Elezit) paga 250 euro**
- **2 Prerës të pyjeve me moto -sharrë (1 nga Komuna e Kaçanikut dhe 1 nga Komuna e Hanit të Elezit) paga 300 euro**
- **4 Punëtor ndihmës të prerësve të pyjeve (2 nga Komuna e Kaçanikut dhe 2 nga Komuna e Hanit të Elezit) paga 250 euro**

Ju njoftoj se për vendin e punës Roje Pylli afati i punës do të jetë **6 muaj**, ndërsa për pozitat tjera afati i punës është **1 muaj**.

Procedura e rekrutimit për këto pozita është e thjeshtësuar.

Të interesuarit (përfshirë edhe kandidatët nga Kaçaniku) duhet të plotësojnë një kërkesë të thjeshtë dhe ta dorëzojnë në zyrën e Pritjes në Komunën e Hanit të Elezit .

Preferohet të kenë të kryer shkollën fillore dhe kërkesës të ja bashkangjesin diplomën e shkollës fillore, diploma tjera **nëse posedojnë** dhe një Cv të tyre. Afati i konkurimit në këtë konkurs është 7 ditë nga dita e publikimit.

Ju njoftoj se puna për pozitat prerës të pyjeve dhe ndihmës të prerësve të pyjeve fillon pas përmirësimit të kushteve klimatike, (konkretisht në momentin kur punëtorët e përmendur do ti nevojiten kompanisë së kontraktuar për shënimin e kufijëve kadastral), gjithsesi kandidatët që do të pranohen në këto pozita do të njoftohen se kur duhet të fillojnë me punë.

Udhëhqësja e Personelit
Ajete Berisha



